



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

Dalës-Izlazna

Nr. V-118
Dr.

Data 03.02.2022
Datum

anglobistika



KOMUNA E OBILIQIT-KOSOVË
OPSTINA OBILIĆ - KOSOVO
MUNICIPALITY OF OBILIQ - KOSOVO

**Kuvendi Komunal Obiliq – Skupstina Opstine Obilic – Municipality Assembly Obiliq
Drejtoria për Planifikim Urban, Pronë dhe Katastër**

Nr. i protokolit dhe data:

Nr i kërkesës :	05-350-2124
Data:	02.02.2022
Për /Za/To:	Shyqeri Mirena
Përmes/Preko/Throug	Zyrës pritëse
Nga/Od/From	Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Pronë
Numri i Lejes ndertimore/	06/2022
Tema/Subjekti/Subjek	-LEJE NDËRTIMORE-

I. Në bazë të Ligjit për Nderim Ligji nr.04/L-110 neni 18, Ligjit për Procedurën Administrative me Nr.05/L-031, neni 27 pika 1, duke vepruar sipas kërkesës nr. 05-350-2124 të dt.26.01.2022 nga Shyqeri Mirena, Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Pronë në procedurë administrative lëshon këtë:

AKTVENDIM

LEJE NDËRTIMORE

Emir i kërkesit:	Shyqeri Mirena
Numri i leternjoftimit të pronarit:	
Numri i certifikates se biznesit:	
Qëllimi i kërkesës:	Marrja e Lejes për ndërtimin e objektit banimor
Qëllimi i ndërtimit:	objekt banimi -P+K-
Nr. i ngastrës kadastrale:	1879-425
Qyteti /Fshati-zona kadastrale:	Zona Kadastrale Obiliq
Lloji i ndërtimit:	Ndërtim i ri

II. Lokacioni për të cilin janë caktuar Kushtet ndërtimore janë dhënë sipas Vendimit për Planin Zhvillimor Urban 2009-2020 me nr.01-166/10 të dt.26.07.2010, Ligjit për Nderim me nr.04/L-110, neni 18, Ligjit për Procedurën Administrative me Nr.05/L-031, neni 27 pika 1 dhe rregullores mbi rregullat dhe procedurat për ndërtimin e objekteve, Vendimit të Departamentit të Shpronësimit nga MAPH, për ndarjen e trojeve në lokacionin "Hade e Re" në Shkabaj për banorët e zhvendosur nga fshati Hade me nr.106/2013 të dt.09.08.2013.

III Parcela ndërtimore numer 1879-425, ka sipërfaqe prej $S=(300.0) m^2$, e drejta pronësore –juridike Shyqeri Mirena, shfrytëzues Shyqeri Mirena, tokë (e ndertuar- e pa ndertuar) me –pa infrastrukturë.

Gabariti dhe etazhiteti i objektit egzistues (I), nuk është nën mbrojtjen e vlerave kulturore e historike.

A. LEJE NDËRTIMORE:

I lejohet Shyqeri Mirena - investitor, ndërtimi i objektit banimor "P+K" tipi "C" në Shkabaj me dimensione:

Përdhesa

-Sbruto = $90 m^2$

Kati:

-Sbruto = $100 m^2$

sipas Kopjes së Planit në ngastrat kadastrale nr. 1879-425 zona kadastrale-Obiliq.

1. Dokumentacionin teknik e ka punuar "ALB-Architect" SHPK (70471952) Prishtinë dhe NPNT "North-West" (70137191) Prishtinë.
2. Dokumentacioni teknik i vërtetuar nga ky organ në bazë të cilit ipet Aktvendimi është pjesë përbërëse e kësaj Leje ndërtimore.
3. Kushtet Ndërtimore nr:V- 2142/21, dt:31.12.2021.
4. Pëlqimin për rregullim të dokumentacionit teknik nga KEDS me nr.428 të datës 21.01.2022.
5. Pëlqimin për dhënien e kushteve teknike nga KUR "Prishtina" SH.A. me nr.267881 të datës 13.01.2022
6. Me rastin e ndërtimit të objektit investuesi është i obliguar :
 - Që të ruaj një ekzemplarë origjinal të dokumentacionit teknik në bazë të të cilit është dhënë Leja e ndërtimit me të gjitha ndryshimet dhe plotësimet e kryera gjatë ndërtimit.
 - Që të sigurojë shënimin e ngastrës ndërtimore, vijës së regulacionit, nivelizimit dhe vijës ndërtimore.
 - Që këtij organi t'i paraqesë fillimin e punëve më së paku në afat prej 8 (tetë) ditësh para fillimit të objektit.
7. Kjo Leje nuk do të vlejë në qoftë se me punët ndërtimore nuk fillohet në afatin prej 1 (një) vit nga dita e lëshuarjes së Lejes së ndërtimit.



ARSYETIM

Shyqeri Mirena për objektin banimor ,ku poashtu i njëjti –është investitor i këtij objekti banimor - me dimensione:

Përdhesa

-Sbruto = 90 m²

Kati:

-Sbruto = 100 m²

ka paraqitur kërkesën për ndertim me numer të protokolit 05-350-2124 të dt.26.01.2022 për dhënjën e Lejes ndërtimore për ndërtimin e objektit banimor të përshkruar në dispozitiv të kësaj Leje ndërtimore.

Së bashku me kërkesën për dhënjën e Lejes ndërtimore, investuesi ka paraqitur :
Projektin kryesorë në së paku 3 (tri) kopje që është kontrolluar nga ana e

Drejtëtoratit për Urbanizëm, Planifikim ,Kadaster dhe Pronë të Komunës së Obiliqit
se ky projekt është bërë në harmoni me kushtet urbanistike-teknike të dhëna nga ky
Drejtëtorat .

- Proven mbi të drejtën e pronësisë të ngastrave kadastrale nr. 1879-425,e evidentuar me nr. të lëndës 05-1118-2021, KK Obiliq të lëshuar nga Drejtëtorati ,
- Kopjen e letërnjoftimit
- Në bazë të vendimit të Kuvendit të KK Obiliq me nr.-I-84/2018 të dt.22.05.02018, banorët e zhvendosur lirohen nga taksat administrative, poashtu edhe në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2018 i dates 29.05.2018 -neni 18 pika 1.3.
- Pasi që investuesi së bashku me kërkesën për dhënjën e lejes ndërtimore ka paraqitur tërë dokumentacionin e paraparë me Ligjit nr.4/L-110, për të cilin është vendosur si në dispozitiv të kësaj Leje të ndërtimore.

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër kësaj Leje ndërtimore mundë të paraqitet ankesë Kryetarit të KK Obiliq në afatin prej 8 (tetë) ditësh nga dita e lëshuarjes së kësaj Leje ndërtimore. Ankesa dërgohet përmes këtij organi.

I dorëzohet:

- Palës
- këtij Drejtorati
- Drejtorisë të inspektorëve
- Dhe në arkiv.

Obiliq, 02.02.2022

Punoi

/ Merita Simnica /

Drejtori

/ Arben Berisha /

14 KOS